



KONTROLLI I LARTË I SHETITIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. 896/7 Prot.

Tiranë, më 31/12/2016

V E N D I M

Nr.192, Datë 31/12 /2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
"Auditimi i Brendshëm dhe Roli i tij në Llogaridhënie"

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 896/3, datë 28.10.2016 realizoi auditimin e performancës me temë "***Auditimi i Brendshëm dhe Roli i tij në Llogaridhënie***". Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 896/4, datë 24.11.2016 iu dërgua projekt-raporti i auditimit Drejtorisë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh shpjegimet e dërguara nga institucioni i përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raportin e Auditimit.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit, në mbështetje të nenit 10, 13, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit":

KONKLUDOVA:

Funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm janë elemente të rëndësishëm në menaxhimin financiar publik dhe në përmirësimin e performancës së sektorit publik në përgjithësi. Për vetë natyrën e tij, auditimi publik mbulon një larmishmëri aktivitesh dhe tematikash, duke vepruar si një mekanizëm i cili i ofron siguri qeverisë dhe ministrive të linjës (*auditimi i brendshëm*), si edhe Kuvendit (*auditimi i jashtëm*) se fondet publike janë shpenzuar në përputhje me kuadrin legjislativ në fuqi, se përdorimi i fondeve publike nga ana e qeverisë përfaqëson në mënyrë të drejtë dhe të saktë pozicionin e saj financiar, si edhe nëse ato janë përdorur me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet në përfitim të taksapaguesve.

Auditimi publik, i konceptuar si auditim i brendshëm dhe auditim i jashtëm publik, tashmë përfaqëson në objektivat e tij jo vetëm problemin ekonomik dhe financiar, por edhe atë social të gjeneruar nga zbatimi i veprimtarisë së qeverisë, duke përfshirë konkretisht edhe lloje të tjera auditimesh që fokusohen në vlerën për para të veprimtarive qeveritare, duke dhënë kontributin kryesor në llogaridhënie në përfitim të taksapaguesve shqiptarë.

Thelbi kryesor i kontributit në llogaridhënie qëndron në bashkëpunimin dypalësh, i cili pavarësisht roleve dhe përgjegjësisë të ndryshme, nxjerr në pah qëllimin e përbashkët të promovimit të mirëqeverisjes duke kontribuar në transparencë, llogaridhënie, si dhe në përdorimin e burimeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet. Misionet e auditimit të jashtëm dhe auditimit të brendshëm ofrojnë mundësi bashkëpunimi dhe koordinimi, i cili pa dyshim duhet të marrë në konsideratë kuadrin ligjor dhe kushtetues që përkufizon këto dy funksione.

Ndryshimi, së fundmi, i bazës ligjore për auditimin e brendshëm publik në shkallë vendi ka ridimensionuar, ndër të tjera, pikërisht konceptimin e bashkëpunimit me auditimin e jashtëm publik në përfitim të llogaridhënies, duke u bazuar në parimet e komunikimit të vazhdueshëm, angazhimit, mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë në tri fusha kryesore: a) shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve; b) shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit; c) zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe trajnimit i përbashkët.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm, ka evidentuar shpesh herë se nuk ka një koordinim dhe bashkëpunim të atillë që të shmangë mbivendosje dhe/ose të nxisë zhvillimin e metodologjive dhe trajnimeve të përbashkëta.

Nisur nga sa më lart, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vendosur të fokusojë vëmendjen e tij në *shtjellimin objektiv dhe të paanshëm të problematikave që ushtrojnë pengesë në bashkëpunimin dyanësh midis auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm, me qëllim sugjerimin e rekomandimeve dhe aktiviteteve të nevojshme në përfitim të mirëqeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies.*

Nisur nga konkluzionet, gjetjet dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e bashkëpunimit midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë *“Auditimi i Brendshëm dhe Roli i tij në Llogaridhënie”*, të ushtruar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

1. Me miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, në Kapitullin 7 është përcaktuar procesi i sigurimit të cilësisë së punës së auditimit të brendshëm i cili nuk është në përputhje dhe në zbatim të Udhëzuesit Praktik 1312 – 1 (*Practice Advisory 1312-1*) të hartuar nga Instituti i Audituesve të Brendshëm. Forma e përzgjedhur për sigurimin e cilësisë është vetëvlerësimi me validim të jashtëm të kryer nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pa përjashtuar vlerësimin e plotë të jashtëm për të cilin nuk është përcaktuar kush do ta kryejë, si do ta kryejë dhe me çfarë metodologjie. Validimi i jashtëm i kryer nga DH/AB bie ndesh me standardin i cili kërkon që vlerësuesi i jashtëm të jetë, në të dyja format e vlerësimit, i pavarur dhe jashtë organizatës. Standardi nuk përcakton konkretisht se cili duhet të jetë vlerësuesi i jashtëm, por përcakton si ai duhet të jetë i pavarur, jashtë organizatës ose sistemit të auditimit të brendshëm, duhet të ketë njohuri dhe praktikë profesionale në fushën e auditimit të brendshëm dhe në procesin e vlerësimit të jashtëm. Një vlerësim i jashtëm i auditimit të brendshëm shërben si një garanci e shtuar lidhur me cilësinë e punës së auditimit të brendshëm në të gjitha aspektet e saj të rëndësishme dhe gjeneron besueshmëri tek përdoruesit e punës së auditimit të brendshëm, si edhe në llogaridhënie.

Për këtë rekomandoj:

1. Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të marrë masa për të hartuar dhe miratuar një Udhëzues për Sigurimin e Cilësisë së punës së Auditimit të Brendshëm në përputhje me standardet e zbatueshme në këtë fushë;

2. Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të hartojë dhe të propozojë pranë instancave përkatëse në Ministrinë e Financave udhëzimet përkatëse me qëllim krijimin e kornizave të përshtatshme për përafrimin me standardet lidhur me sigurimin e cilësisë së auditimit të brendshëm.

Në Vijimësi

2. Pavarësisht, nënshkrimi të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 191/5 prot., më datë 08.05.2012 midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhur me bashkëpunimin kryesisht në shkëmbimin e planeve strategjike, planeve të auditimit, trajnimin e stafit, trajnimet e përbashkëta, takime dhe mbledhje bashkëpunimi si dhe mbështetjen e punës së auditimit të jashtëm në punën e auditimit të brendshëm me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe dublikimin e punës audituese, në përfitim të mirëqeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies, konstatohet se kanë munguar propozime konkrete për sa i takon aspekteve kyçe të bashkëpunimit midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe se ekziston e është i konsoliduar besimi se operimi sipas standardeve të ndryshme pengon zhvillimin dhe vendosjen në praktikë të teknikave dhe metodologjive audituese të përbashkëta. Standardi 2050 i auditimit të brendshëm, bashkëpunimin me auditimin e jashtëm e cilëson si një mënyrë për të siguruar një mbulim të mjaftueshëm me auditim dhe për të shmangur mbivendosjet në punën audituese. Udhëzuesi Praktik 2050 – 1, në paragrafin 4 cilëson si një mënyrë eficiente përdorimin e teknikave, metodologjive dhe terminologjive të ngjashme, me qëllim një koordinim efektiv të punës për të favorizuar dhe lehtësuar punën e gjithsecilit dhe për të nxitur gjithashtu besimin reciprok në profesionalizmin e ushtruar gjatë punës audituese. Nga këndvështrimi i standardeve të auditimit të jashtëm, INTOSAI Govs 9150 nuk ekziston një pengesë e tillë dhe SAI-t inkurajohen në këtë drejtim.

Për këtë rekomandoj:

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për hartimin dhe propozimin e metodologjive, standardeve dhe teknikave të auditimit në sektorin e auditimit të brendshëm publik në Shqipëri, me qëllim nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit dhe koordinimit në përfitim të llogaridhënies dhe mirëqeverisjes, për të evituar mbivendosjet dhe dublikimet e punës audituese, të angazhohet për të evidentuar hapësirat e zhvillimit të metodologjive dhe teknikave të përbashkëta në fushën e auditimit në zbatim të standardeve, duke nxjerrë në pah edhe mundësitë për të kryer auditime të pilotuara së bashku me Kontrollin e Lartë të Shtetit për të testuar saktësinë e tyre, me qëllim nxitjen e përdorimit të punës së njëri tjetrit.

Në Vijmësi

3. Në programet e trajnimit për certifikimin e audituesve të brendshëm publikë në shkallë vendi të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave janë përfshirë njohuri bazë për funksionin e auditimit të jashtëm publik dhe përmbajtja e tyre adreson aspekte të cekëta të veprimtarisë së auditimit të jashtëm publik në përgjithësi, si për shembull çfarë është auditimi i jashtëm dhe nevoja për auditimin e jashtëm, duke mos trajtuar konkretisht aspektet më të rëndësishme të funksionit të auditimit të jashtëm në Shqipëri, si edhe duke mos përmendur aspak marrëdhënien konkrete midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, standardet përkatëse dhe ku ato takohen me njëri tjetrin, dhe rolin e gjithësecilit në llogaridhënie.

Për këtë rekomandoj:

1. Me qëllim ndërgjegjësimin dhe aftësimin profesional të audituesve të brendshëm në fushën e auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, rolit të tij në llogaridhënie, marrëdhëniet e bashkëpunimit midis auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm, shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave në fushën e standardeve, metodologjive dhe teknikave të auditimit, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave të anagazhohet në përditësimin e përmbajtjes së Kurrikulave trajnuese certifikuese për audituesit e brendshëm në fushën e auditimit të jashtëm.

2. Duke synuar dhënien e një kontributi cilësor dhe impakt-prodhues të përbashkët në mirëqeverisje dhe llogaridhënie në përfitim të taksapaguesve shqiptarë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, të marrë masa dhe të angazhohet në kryerjen e trajnimeve të përbashkëta me Kontrollin e Lartë të Shtetit duke synuar shtjellimin e metodologjive dhe teknikave të auditimit me qëllim favorizimin e përdorimit punës së njëri-tjetrit.

Në Vijmësi

III. Të Tjera

1. Duke synuar një realizim sa më efektiv të trajnimeve të përbashkëta në fushën e auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm publik në Shqipëri, Kontrolli i Lartë i Shtetit të përditësojë kurrikulat trajnuese për sa i takon fushës së auditimit të brendshëm publik në Shqipëri me qëllim reflektimin e ndryshimeve të fundit në legjislacion, metodologji dhe standarde.

2. Nisur nga konstatimi i drejtimit të lartë të KLSH se ky auditim nuk ka qenë gjithëpërfshirës, por i fokusuar vetëm në bashkëpunimin midis auditimit të jashtë publik dhe atij të brendshëm, si edhe nga dyshimi i arsyeshëm që KLSH ka konfirmuar me kohë, se performanca e auditimit të brendshëm krahasuar me atë të jashtëm publik në parametra të tilla si: nr. i auditimeve për nr. audituesish, nr. i gjetjeve, nr. i konkluzioneve, rekomandimeve, masave organizative e ligjore, nr. i subjekteve të mbuluara me auditim përgjatë kohës dhe me burimet në dispozicion, lë për të dëshiruar nga ana e auditimit të brendshëm, për vitin 2017 KLSH do të angazhohet për të ndërmarrë një auditim performance me një fokus më të gjerë në këtë pikë, pas rezultateve të auditimit të përputhshmërisë të planifikuar për tu realizuar në Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

KRYETAR